



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.34

7 mars

2008

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i Kuvendit nr.162, datë 28.2.2008	Për një ndryshim në vendimin nr.94, datë 30.4.2007 të Kuvendit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU)”.....	1529
Dekret nr.5648 datë 29.2.2008	Për emërimin e rektorit të Universitetit Ushtarak “Skënderbej”	1531
Vendim i KM nr.210, datë 21.2.2008	Për lejimin e kalimit transit të një kontingjenti ushtarak slloven përmes territorit të Republikës së Shqipërisë	1531
Vendim i KM nr.213, datë 21.2.2008	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Klos”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë.....	1532
Vendim i KM nr.214, datë 21.2.2008	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Bishnica 2”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë	1533
Vendim i KM nr.215, datë 21.2.2008	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Gur Shpat”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë	1533
Vendim i KM nr.216, datë 21.2.2008	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Bëncë”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë..	1534

Vendim i KM nr.217, datë 21.2.2008	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Niçe”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën për zgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë	1534
Vendim i KM nr.219, datë 28.1.2008	Për caktimin e tarifave të shërbimit nga Posta Shqiptare sh.a. dhe shërbimi konsullor, në zbatim të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë, të regjimit komunist”	1535
Vendim i KM nr.221, datë 13.2.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësive të qeverisjes vendore, komuna Nikël të qarkut të Durrësit	1535
Vendim i KM nr.222, datë 13.2.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësive të qeverisjes vendore, bashkia Berat të qarkut të Beratit	1540
Udhëzim i MPPTT nr.2/1, datë 3.3.2008	Për një ndryshim në udhëzimin nr.20, datë 10.10.2007 “Për modelet e licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”	1544
Vendim i GJK nr.5, datë 4.3.2008	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.538, datë 27.6.2007 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si antikushtetues.....	1549
Vendim i GJK nr.6, datë 5.3.2008	Me objekt interpretimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr.9, datë 11.5.2006.....	1551

VENDIM
Nr.162, datë 28.2.2008

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.94, DATË 30.4.2007 TË KUVENDIT “PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE ORGANIKËS SË ENTIT RREGULLATOR TË
SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË
NDOTURA (ERRU)”**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, neneve 9 pika 2 dhe 10 pika 1 të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, me propozimin e Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU),

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.94, datë 30.4.2007 të Kuvendit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU)”, lidhja nr.2 “Organika e Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura” zëvendësohet me lidhjen nr.2 bashkëlidhur.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

**ORGANIKA E DETAJUAR E ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT
ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA (ERRU)**

KOMISIONI I ERRU-SË	Kategoria e pagës	Numri i punonjësve
KRYETARI		1
ANËTARË KOMISIONI		4
Sekretarja e Komisionit dhe Kryetarit		1
DREJTORIA TEKNIKO-EKONOMIKE		8
Drejtor drejtorie		1
Sektor Teknik dhe IT		
Përgjegjës sektori	III-a	1
Specialist i rrjeteve inxhinierike të ujësjellësve dhe ITUP	III-b	1
Specialist i rrjeteve inxhinierike të KUZ dhe ITUZ	III-b	1
Specialist i licencave dhe IT	III-b	1
Spektori Ekonomik dhe Monitorues		
Përgjegjës sektori	III-a	1
Specialist i vlerësimit të kostos dhe tarifave	III-b	1
Specialist i monitorimit dhe verifikimit të treguesve të punës	III-b	1
Spektori Juridik dhe i Marrëdhënies me Publikun		
Përgjegjës sektori	III-a/1	1
Specialist	III-b	1
Spektori i Administratës, Financës dhe Burimeve Njerëzore		
Përgjegjës sektori	III-a/1	1
Specialist finance	III-b	1
Punonjës mbështetës		
Arkivist-protokollist		1
Shoferë		2
		21

DEKRET
Nr.5648, datë 29.2.2008

PËR EMËRIMIN E REKTORIT TË UNIVERSITETIT USHTARAK “SKËNDERBEJ”

Në mbështetje të nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 8 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes,

DEKRETOJ:

Neni 1

Prof. Dr.Elmaz Leci emërohet Rektor i Universitetit Ushtarak “Skënderbej”.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr.210, datë 21.2.2008

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË NJË KONTINGJENTI USHTARAK SLLOVEN
PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 16 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit transit të një kontingjenti ushtarak slloven përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Porti i Durrësit-Qafë-Thanë, në datën 21 shkurt 2008 dhe kthim Qafë-Thanë-Porti i Durrësit, më 28 shkurt 2008.

2. Kalimi transit do të bëhet i ndarë në disa faza, si më poshtë vijon:

- Në datën 21.2.2008 do të vijnë në Portin e Durrësit 73 automjete ushtarake, së bashku me 10 (dhjetë) shoferë.

- Në datën 21.2.2008, në orën 15.00, do të arrijnë në Aeroportin e Rinasit dhe do të shkojnë në Portin e Durrësit me autobus edhe 136 shoferë të tjerë.

- Mënyra e transitimit do të jetë me 4 autokolona, me nga 19, 18, 18 e 18 automjete, që do të nisen nga Porti i Durrësit, përkatësisht në orën 16.00, 16.30, 17.00 dhe 17.30. Autokolonat parashikohet të arrijnë në Qafë-Thanë në orën 19.00, 19.30, 20.00 dhe 20.30.

- Në datën 28.2.2008 do të hyjnë në Qafë-Thanë dhe do të shkojnë në Portin e Durrësit 27 automjete ushtarake.

- Mënyra e transitimit do të jetë me 2 autokolona, me 14 e 13 automjete. Autokolonat do të hyjnë në Qafë-Thanë, përkatësisht në orën 4.30 dhe 7.30 dhe parashikohet të arrijnë në Portin e Durrësit në orën 9.00 dhe 10.00.

3. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në/nga Republika e Shqipërisë janë parashikuar në “Marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave”, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, në “Marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i

përket statusit të forcave të tyre”, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe në protokollin shtesë të “Marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera, pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre”, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

4. Kontingjenti sloven, gjatë itinerarit të lëvizjes nga Porti i Durrësit-Qafë-Thanë dhe Qafë-Thanë-Porti i Durrësit, të shoqërohet nga njësi të Policisë Ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

5. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.213, datë 21.2.2008

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “KLOS”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23 pika 3 shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Klos” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 4.5 për qind të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese për zgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Malido” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Klos” të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.214, datë 21.2.2008

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “BISHNICA 2”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3 e 23 pika 3 shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Bishnica 2” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 5 për qind të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Titan” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në procedurën konkurruese për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Bishnica 2” të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.215, datë 21.2.2008

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “GUR SHPAT”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23 pika 3 shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Gur Shpat” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 4.5 për qind të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Arjana C” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në procedurën konkurruese për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Gur Shpat” të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.216, datë 21.2.2008

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALIT “BËNÇË”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23 pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Bënçë” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 5 për qind të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Ferar” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Bënçë”, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.217, datë 21.2.2008

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALIT “NIÇE”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23 pika 3, shkronja “b”, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Niçe” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 3.5 për qind të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Devy” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Niçe” të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.219, datë 28.1.2008

PËR CAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT NGA POSTA SHQIPTARE SHA DHE SHËRBIMI KONSULLOR, NË ZBATIM TË LIGJIT NR.9831, DATË 12.11.2007 “PËR DËMSHPËRBLIMIN E ISH-TË DËNUARVE POLITIKË, TË REGJIMIT KOMUNIST”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21 të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë, të regjimit komunist”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në zbatim të nenit 21 të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë, të regjimit komunist”, të zbatohen këto tarifa shërbimi:

a) Nga Posta Shqiptare sh.a.:

i) për qytetin e Tiranës, 70 lekë, për aplikim;

ii) për qytetet dhe zonat jashtë Tiranës, 100 lekë, për aplikim.

b) Nga shërbimi konsullor i Republikës së Shqipërisë 15 euro, për aplikim.

2. Formularët tip të aplikimit, që do të plotësohen nga aplikuesit, dërgohen nga Ministria e Drejtësisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.221, datë 13.2.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA, QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE, KOMUNA NIKËL TË QARKUT TË DURRËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ, të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Nikël të qarkut të Durrësit, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 3 (tre) fletë, që përfundon me numrin rendor 82 (tetëdhjetë e dy), dhe lidhja 1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Nikël për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

FORMULARE PER TRANSFERIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE
(Sipas inventarizimit te pronave te vecanta te tipit,Pyje,Kullota,Livadhe,Shkembore etj)

Institucioni i Pushtetit Qendror: M.M.P.A.U											
Komuna Nikel											
Nr rendor	Nr l prones sipas VKM	Emertesa e Ekonomise Pyjore dhe kullësore (PPK) Shtirnja Gjeografike PPK	Emertesa e ngastres Vendodhja (sipas emertes ngastres Popullore)	Numri i ngastres	Destinacioni	Siper ne Ha	Funksioni per te cilin perdoret prona	Institucioni enti me pergjegjes administrativ	Institucioni Enti perdorues stat i juridik l perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te vecanta)	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	
1	104	Bura - Mukje (Ek. P.)	Kodra e Tafëve	1	Pyll prodhues	5.00	L.punim+Dru zjarri	MMPAU (DPPK)	DSHP	Me Aktmarveshjen	
2	105	Bura - Mukje (Ek. P.)	Faqia e proit Çibuk	2	Pyll prodhues	5.00	L.punim+Dru zjarri	MMPAU (DPPK)	DSHP	Nr. 701/1, dt. 25.05.01	
3	106	Bura - Mukje (Ek. P.)	Kodra e Hakëve	3	Pyll prodhues	68.00	Dru zjarri	MMPAU (DPPK)	DSHP	i kalon në perdorim	
4	107	Bura - Mukje (Ek. P.)	Pylli ke vreshti	4	Pyll prodhues	2.00	L.punim+Dru zjarri	MMPAU (DPPK)	DSHP	Komunës NIKËL	
5	108	Bura - Mukje (Ek. P.)	Kodër Kurji	1	Pyll prodhues	15.00	L.puni+Dru zjarri	MMPAU (DPPK)	DSHP	Me Aktmarveshjen	
6	109	Bura - Mukje (Ek. P.)	Faqia e Liqenit	2	Pyll prodhues	2.00	Dru zjarri	MMPAU (DPPK)	DSHP	Nr. 701/1, dt. 25.05.01	
7	110	Bura - Mukje (Ek. P.)	Drunjës	3	Pyll prodhues	7.00	Dru zjarri	MMPAU (DPPK)	DSHP	i kalon në perdorim	
8	111	Bura - Mukje (Ek. P.)	Kodër Kullë	4	Pyll prodhues	16.00	Dru zjarri	MMPAU (DPPK)	DSHP	komunës NIKËL	
9	112	Bura - Mukje (Ek. P.)	Faqia e V.SH.Vrionit	5	Pyll prodhues	61.00	Dru zjarri	MMPAU (DPPK)	DSHP	fshati VRION	
10	113	Bura - Mukje (Ek. P.)	Kodër Vrion	6	Pyll prodhues	45.00	Dru zjarri	MMPAU (DPPK)	DSHP		
11	114	Bura - Mukje (Ek. P.)	Lapore	7	Pyll prodhues	21.00	Dru zjarri	MMPAU (DPPK)	DSHP		
12	115	Bura - Mukje (Ek. P.)	Faqia e Zezë	1	Pyll mbrojtës	75.00	Mbrojtës fshati	MMPAU (DPPK)	DSHP	Me Aktmarveshjen	
13	116	Bura - Mukje (Ek. P.)	Kazave	2	Pyll prodhues	3.00	Dru zjarri	MMPAU (DPPK)	DSHP	Nr. 701/1, dt. 25.05.01	
14	117	Bura - Mukje (Ek. P.)	Shpati i Shkrepit	3	Pyll prodhues	21.00	Dru zjarri	MMPAU (DPPK)	DSHP	i kalon në perdorim	
15	118	Bura - Mukje (Ek. P.)	Rana e Tares	4	Pyll mbrojtës	6.00	Mbrojtës fshati	MMPAU (DPPK)	DSHP	Komunës NIKËL	
16	119	Bura - Mukje (Ek. P.)	Sharore	5	Pyll prodhues	28.00	Dru zjarri	MMPAU (DPPK)	DSHP	fshati KURCAJ	
17	120	Bura - Mukje (Ek. P.)	Bir Uk	6	Pyll mbrojtës	61.00	Mbrojtës fshati	MMPAU (DPPK)	DSHP		
18	121	Bura - Mukje (Ek. P.)	Kole Poqe	1	Pyll prodhues	4.00	Dru zjarri	MMPAU (DPPK)	DSHP	Me Aktmarveshjen	
19	122	Bura - Mukje (Ek. P.)	Kodër Mllash	2	Pyll prodhues	21.00	Dru zjarri	MMPAU (DPPK)	DSHP	Nr. 701/1, dt. 25.05.01	
20	123	Bura - Mukje (Ek. P.)	Faqe shkëmbit Gamit	3	Pyll mbrojtës	5.00	Mbrojtës toke	MMPAU (DPPK)	DSHP	i kalon në perdorim	
21	124	Bura - Mukje (Ek. P.)	Vollëz Lidari	4	Pyll prodhues	15.00	Dru zjarri	MMPAU (DPPK)	DSHP	Komunës NIKËL	

22	125	Bura - Mukje (Ek. P.)	Kodër Hula	5	Pyll prodhues	53.00	Dru zjarri	MMPAU (DPPK)	DSHP	fshati BURA
23	126	Bura - Mukje (Ek. P.)	Argjesh i Mukjes	1	Pyll Prodhuës	38.00	Dru zjarri	MMPAU (DPPK)	DSHP	Me Akimarveshjen
24	127	Bura - Mukje (Ek. P.)	Argjesh i Mukjes	2	Pyll Prodhuës	13.00	Dru zjarri	MMPAU (DPPK)	DSHP	Nr.701/1, dt. 25.05.01
25	128	Bura - Mukje (Ek. P.)	Maja e kabushit	3	Pyll Prodhuës	17.00	Dru zjarri	MMPAU (DPPK)	DSHP	i kalon në perdorim
26	129	Bura - Mukje (Ek. P.)	Faqe Shullanit	4	Pyll Prodhuës	95.00	Dru zjarri	MMPAU (DPPK)	DSHP	Komunës NIKËL
27	130	Bura - Mukje (Ek. P.)	Fiere, Saraje, Shin	5	Pyll Prodhuës	35.00	Dru zjarri	MMPAU (DPPK)	DSHP	fshati MUKJE
28	131	Bura - Mukje (Ek. P.)	Shpati i Gamit	6	Pyll mbrojtës	28.00	Mbrojtës i fshatit	MMPAU (DPPK)	DSHP	
29	132	Tërkuzë Drojë (Ek. P.)	Shejgjet	1	Pyll prodhues	2.20	Dru zjarri	MMPAU (DPPK)	DSHP	Me Akimarveshjen
30	133	Tërkuzë Drojë (Ek. P.)	Shejgjet	2	Pyll prodhues	2.80	L.punimit+Dru zjarri	MMPAU (DPPK)	DSHP	Nr.701/1, dt. 25.05.01
31	134	Tërkuzë Drojë (Ek. P.)	Shejgjet	3	Pyll mbrojtës	0.50	Mb.qender banimi	MMPAU (DPPK)	DSHP	Komunës NIKËL
32	135	Tërkuzë Drojë (Ek. P.)	Shejgjet	4	Pyll mbrojtës	2.40	Mb.qender banimi	MMPAU (DPPK)	DSHP	fshati NIKËL
33	136	Tërkuzë Drojë (Ek. P.)	Bege	5	Pyll mbrojtës	0.60	Mb.qender banimi	MMPAU (DPPK)	DSHP	
34	137	Tërkuzë Drojë (Ek. P.)	Bege	6	Pyll mbrojtës	27.00	Mb.qender banimi	MMPAU (DPPK)	DSHP	
35	138	Tërkuzë Drojë (Ek. P.)	Bege	7	Pyll prodhues	0.50	Dru zjarri	MMPAU (DPPK)	DSHP	
36	139	Tërkuzë Drojë (Ek. P.)	Bege	8	Pyll mbrojtës	0.30	Mb.qender banimi	MMPAU (DPPK)	DSHP	
37	140	Tërkuzë Drojë (Ek. P.)	Bege	9	Pyll mbrojtës	1.20	Mb.qender banimi	MMPAU (DPPK)	DSHP	
38	141	Tërkuzë Drojë (Ek. P.)	Bege	10	Pyll mbrojtës	1.30	Pyll prodhues	MMPAU (DPPK)	DSHP	
39	142	Tërkuzë Drojë (Ek. P.)	Çenge	1	Pyll mbrojtës	0.70	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	Me Akimarveshjen
40	143	Tërkuzë Drojë (Ek. P.)	Breg Lumi Tërkuzë	2	Pyll mbrojtës	4.80	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	Nr.701/1, dt. 25.05.01
41	144	Tërkuzë Drojë (Ek. P.)	Topallët	3	Pyll mbrojtës	6.80	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	i kalon në perdorim
42	145	Tërkuzë Drojë (Ek. P.)	Topallët	4	Pyll mbrojtës	1.80	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	Komunës NIKËL
43	146	Tërkuzë Drojë (Ek. P.)	Topallët	5	Pyll mbrojtës	2.00	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	fshati TAPIZË
44	147	Tërkuzë Drojë (Ek. P.)	Topallët	6	Pyll mbrojtës	1.90	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	
45	148	Tërkuzë Drojë (Ek. P.)	Fisi Lila	7	Pyll mbrojtës	2.00	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	
46	149	Tërkuzë Drojë (Ek. P.)	Breg lumi Stafët	8	Pyll mbrojtës	3.30	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	
47	150	Tërkuzë Drojë (Ek. P.)	Kal Mistrec	1	Pyll mbrojtës	1.00	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	Me Akimarveshjen
48	151	Tërkuzë Drojë (Ek. P.)	Kal Mistrec	2	Pyll mbrojtës	1.60	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	Nr.701/1, dt. 25.05.01
49	152	Tërkuzë Drojë (Ek. P.)	Kal Mistrec	3	Pyll mbrojtës	4.60	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	i kalon në perdorim
50	153	Tërkuzë Drojë (Ek. P.)	Zallishte Tërkuyës	4	Pyll mbrojtës	2.80	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	Komunës NIKËL
51	154	Tërkuzë Drojë (Ek. P.)	Zallishte Tërkuyës	5	Pyll mbrojtës	0.80	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	fshati QERREKË
52	155	Tërkuzë Drojë (Ek. P.)	Zallishte Tërkuyës	6	Pyll mbrojtës	2.90	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	
53	156	Tërkuzë Drojë (Ek. P.)	Zalli Ballistëve	7	Pyll mbrojtës	4.60	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	
54	157	Tërkuzë Drojë (Ek. P.)	Zalli i Muqeve	8	Pyll mbrojtës	5.00	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	
55	158	Tërkuzë Drojë (Ek. P.)	Zalli Bunkerëve	9	Pyll mbrojtës	3.70	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	
56	159	Tërkuzë Drojë (Ek. P.)	Zalli i Dollinës	10	Pyll mbrojtës	1.70	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	
57	160	Tërkuzë Drojë (Ek. P.)	Yalli Kurtëve	11	Pyll mbrojtës	2.50	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	

58	161	Tërkuzë Drojë (Ek. P)	Zalli i Lulëve	12	Pyll mbrojtës	0.80	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	
59	162	Tërkuzë Drojë (Ek. P)	Zalli i Muçeve	13	Pyll mbrojtës	0.40	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	
60	163	Tërkuzë Drojë (Ek. P)	Zalli i Tahireve	14	Pyll mbrojtës	2.70	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	
61	164	Tërkuzë Drojë (Ek. P)	Navake	15	Pyll mbrojtës	2.00	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	
62	165	Tërkuzë Drojë (Ek. P)	Navake	16	Pyll mbrojtës	1.30	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	
63	166	Tërkuzë Drojë (Ek. P)	Navake	1	Pyll mbrojtës	0.60	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	Me Aktmarrveshjen
64	167	Tërkuzë Drojë (Ek. P)	Navake	2	Pyll mbrojtës	2.30	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	Nr. 701/1, dt. 25.05.01
65	168	Tërkuzë Drojë (Ek. P)	Navake	3	Pyll mbrojtës	1.50	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	i kalon në përdorim
66	169	Tërkuzë Drojë (Ek. P)	Bregu Tërkuzës	4	Pyll mbrojtës	1.40	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	Komunës NIKËL
67	170	Tërkuzë Drojë (Ek. P)	Ura e Rinasit	5	Pyll mbrojtës	0.30	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	fshati RINAS
68	171	Tërkuzë Drojë (Ek. P)	Gjami Gjoles	6	Pyll mbrojtës	0.40	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	
69	172	Tërkuzë Drojë (Ek. P)	Brraka	7	Pyll mbrojtës	0.80	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	
70	173	Tërkuzë Drojë (Ek. P)	Gjami Gjoles	8	Pyll mbrojtës	0.80	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	
71	174	Tërkuzë Drojë (Ek. P)	Gjami Gjoles	9	Pyll mbrojtës	2.70	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	
72	175	Tërkuzë Drojë (Ek. P)	Guxhare	10	Pyll mbrojtës	1.70	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	
73	176	Tërkuzë Drojë (Ek. P)	Brraka	11	Pyll mbrojtës	0.90	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	
74	177	Tërkuzë Drojë (Ek. P)	Brraka	12	Pyll mbrojtës	0.40	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	
75	178	Tërkuzë Drojë (Ek. P)	Brraka	13	Pyll mbrojtës	0.80	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	
76	179	Tërkuzë Drojë (Ek. P)	Brraka	14	Pyll mbrojtës	2.20	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	
77	180	Tërkuzë Drojë (Ek. P)	Brraka - Tunelet	15	Pyll mbrojtës	1.20	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	
78	181	Tërkuzë Drojë (Ek. P)	Brraka	16	Pyll mbrojtës	1.00	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	
79	182	Tërkuzë Drojë (Ek. P)	Brraka	17	Pyll mbrojtës	0.60	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	
80	183	Tërkuzë Drojë (Ek. P)	Brraka	18	Pyll mbrojtës	0.90	Mbrojtës tokë buke	MMPAU (DPPK)	DSHP	
81	184	Krastë Krujë (Ek. Kullosores)	Kodër zezë	1	Kullotë	26.00	Kullotë	Komuna-NIKËL	Komun-NIKËL	
82	185	Krastë Krujë (Ek. Kullosores)	Kodër Kullë	2	Kullotë	47.00	Kullotë	Komuna-NIKËL	Komun-NIKËL	

përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Berat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

2. FORMULAR PER TRANSFERIMIN E PRONAVE TE PALUAJTESHME SHTETERORE
(Mbeshtetur ne inventarizimin e pronave te veçanta te tipit kullota , livadhe, shkembore etj)

Institucioni I Pushtetit Qendror										
MMPAU										
Bashkia										
BERAT										
Nr	Numri pasurise sipas VKM	Emertesa e Ekonomise Pyjore dhe kullorosore (EPK)	Emertesa e ngastres Vendodhja sipas emertes popullore	Numri ngastres	Destinacioni	Siperfaqe ne ha	Funksioni per te cilen perdoret pronja	Institucioni Enti me pergjegjesite administrative	Institucioni Enti perdorues Statusi juridik I perdorimit	Te dhena te tjera Shenime te Veçanta
1	1374	Hija e Roshnikut	Qendar e Ilacit	1.c	Zhavorishte	4	Zhavorishte	M.M.P.A.U	Bashkia Berat	
2	1375	Hija e Roshnikut	Kalaja e Beratit	2.a	Trungishte	1,7	L.p +dr.zjarri	M.M.P.A.U	Bashkia Berat	
3	1376	Hija e Roshnikut	Kalaja e Beratit	2.b	Trungishte	7	L.p +dr.zjarri	M.M.P.A.U	Bashkia Berat	
4	1377	Hija e Roshnikut	Kalaja e Beratit	2.d	Trungishte	2,3	L.p +dr.zjarri	M.M.P.A.U	Bashkia Berat	
5	1378	Hija e Roshnikut	Kalaja e Beratit	3.a	Shkembore	6	Shkembore	M.M.P.A.U	Bashkia Berat	
6	1379	Hija e Roshnikut	Kalaja e Beratit	3.b	Trungishte	5	L.p +dr.zjarri	M.M.P.A.U	Bashkia Berat	
7	1380	Hija e Roshnikut	Lagje agjensia	4.a	Trungishte	8	L.p +dr.zjarri	M.M.P.A.U	Bashkia Berat	
8	1381	Hija e Roshnikut	Lagje agjensia	5.b	Trungishte	12	L.p +dr.zjarri	M.M.P.A.U	Bashkia Berat	
9	1382	Hija e Roshnikut	Shen Thanas	7.b	Trungishte	0,5	L.p +dr.zjarri	M.M.P.A.U	Bashkia Berat	
10	1383	Hija e Roshnikut	Shen Thanas	7.b	Trungishte	0,3	L.p +dr.zjarri	M.M.P.A.U	Bashkia Berat	Private
11	1384	Hija e Roshnikut	Perroi I xanes	7.c	Boshe	5	Boshe	M.M.P.A.U	Bashkia Berat	
12	1385	Hija e Roshnikut	Argjinature	8.a	Trungishte	4,85	Mbrojtes	M.M.P.A.U	Bashkia Berat	
13	1386	Hija e Roshnikut	Argjinature	8.b	Kthyer troje	15,95	Kthyer troje	M.M.P.A.U	Bashkia Berat	
14	1387	Hija e Roshnikut	Argjinature	8.c	Shkurre	3,2	Mbrojtes	M.M.P.A.U	Bashkia Berat	Private
15	1388	Hija e Roshnikut	Dredhja e Zgares	9.c	Shkembore	6	Shkembore	M.M.P.A.U	Bashkia Berat	
16	1389	Hija e Roshnikut	Kandar	10.b	Shkure	6,8	D.zjarri	M.M.P.A.U	Bashkia Berat	
17	1390	Hija e Roshnikut	Kandar	10.b	Shkure	6	D.zjarri	M.M.P.A.U	Bashkia Berat	Private
18	1391	Hija e Roshnikut	Kandar	10.c	Trungishte	7,2	L.p +dr.zjarri	M.M.P.A.U	Bashkia Berat	
19	1392	Hija e Roshnikut	Kandar	10.c	Trungishte	4	L.p +dr.zjarri	M.M.P.A.U	Bashkia Berat	Private
20	1393	Hija e Roshnikut	Kandar	11.b	Trungishte	13,3	L.p +dr.zjarri	M.M.P.A.U	Bashkia Berat	Private
21	1396	Hija e Roshnikut	Kullan Uznove	55.a	Shkurre	11,5	L.p +dr.zjarri	M.M.P.A.U	Bashkia Berat	
22	1397	Hija e Roshnikut	Kullan Uznove	55.b	Zallishte	46	Zallishte	M.M.P.A.U	Bashkia Berat	

Njësia e Qeverisjes Vendore Bashkia Berat

Lidhja 1

[illegible]

UDHËZIM

Nr.2/1, datë 3.3.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.20, DATË 10.10.2007 “PËR MODELET E LICENCAVE, AUTORIZIMEVE DHE CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, nenit 5 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar dhe të udhëzimit nr.2, datë 18.1.2008 “Mbi një ndryshim në udhëzimin nr.15, datë 24.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave, për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

UDHËZON:

1. Në pikën 4 të udhëzimit nr.20, datë 10.10.2007 “Për modelet e licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, modeli nr.113, ndryshohet dhe shtohet modeli 114 si më poshtë vijon:

Modeli	Emërtimi	Ngjyra	Stema/simboli	Shenja të tjera
1.LICENCA				
114	Licencë për kompetencë profesionale në fushën e transportit dhe sigurisë rrugore	E bardhë	Stema e Republikës	Nuk ka

2. Modeli i ndryshuar nr.113 dhe modeli nr.114 janë bashkëlidhur këtij udhëzimi.
3. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT
DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E LIÇENCIMIT

LIÇENCË

Nr. _____, datë ____/____/____

PËR

**KONSULENCË TEKNIKO – EKONOMIKE NË VEPRIMTARITË
E TRANSPORTIT RRUGOR**

I LËSHOHET:

Personit Fizik/Juridik: _____

Administratori: _____

Me seli në: _____

Fushat e konsulencës:

.....
.....
.....
.....

Liçenca është e vlefshme deri më datën ____/____/____

Firma dhe Vula
e Autoritetit Kompetent

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Kjo liçencë i jep të drejtën mbajtësit të saj të ushtrojë veprimtarinë e konsulencës tekniko - ekonomike në një ose disa nga fushat e mëposhtme:
 - a) Drejtimin e veprimtarive të sipërmarrjeve dhe agjencive të transportit rrugor për udhëtarë dhe mallra;
 - b) Ekspertizë në njohjen dhe zbatimin e legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e transportit rrugor.
 - c) Përcaktimin e kërkesave tekniko-ekonomike në blerjen e makinerive dhe pajisjeve për sektorë të ndryshëm të transportit.
 - d) Ekspertizë për llogaritjen e kostove operacionale dhe optimeve ekonomike në operacionet e transportit të brendshëm dhe ndërkombëtar të udhëtarëve dhe të mallrave.
 - e) Këshillimin, asistencën në lidhje me plotësimin e dokumentacionit të kërkuar për operim në transport.
2. Liçenca nuk mund të transferohet nga mbajtësi (titullari) i saj tek një subjekt tjetër.
3. Liçenca është e pavlefshme kur:
 - a) i ka përfunduar afati i vlefshmërisë,
 - b) në të janë bërë të palexueshme ose mungojnë specifikimet e mëposhtme:
 - emri i shoqërisë dhe adresa e selisë;
 - nënshkrimi i autoritetit kompetent dhe vula përkatëse;
 - data e fillimit dhe mbarimit të periudhës së vlefshmërisë;
4. Liçenca hiqet nga Autoriteti Kompetent që e ka lëshuar atë, kur:
 - Subjekti nuk plotëson më kushtet e kërkuara si, reputacion i mirë, kompetence profesionale dhe gjendje të përshtatshme financiare.
 - Provohet se subjekti ka paraqitur informacion jo të sakte dhe/ose të falsifikuar në lidhje me të dhënat e kërkuara për marrjen e liçencës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E LIÇENCIMIT

LIÇENCË

Nr. _____, datë ____/____/____

PËR

KOMPETENCË PROFESIONALE NË FUSHËN E
TRANSPORTIT DHE SIGURISË RRUGORE

I LËSHOHET:

Personit Fizik:

Datëlindja:

Vendbanimi:

Diplomuar më:

Titulli:

Fushat e kompetencës:

a. Ekspert në njohjen dhe zbatimin e legjislacionit të trafikut rrugor, sigurisë së qarkullimit të mjeteve në rrugë.

b. Ekspert autoteknik dhe vlerësues i dëmeve që shkakton mjete rrugor gjatë aksidentit në rrugë.

Liçenca është e vlefshme deri më datën ____/____/____

Firma dhe Vula
e Autoritetit Kompetent

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Kjo liçencë i jep të drejtën mbajtësit të saj të ushtrijë veprimtarinë e kompetencës profesionale në fushat e mëposhtme:
 - a) Ekspert në njohjen dhe zbatimin e legjislacionit të trafikut rrugor, sigurisë së qarkullimit të mjeteve në rrugë.
 - b) Ekspert autoteknik dhe vlerësues i dëmeve që shkakton mjeti rrugor gjatë aksidentit në rrugë.
2. Liçenca nuk mund të transferohet nga mbajtësi (titullari) i saj tek një person tjetër.
3. Liçenca është e pavlefshme kur:
 - a) i ka përfunduar afati i vlefshmërisë,
 - b) në të janë bërë të palexueshme ose mungojnë specifikimet e mëposhtme:
 - emri i personit dhe adresa;
 - nënshkrimi i autoritetit kompetent dhe vula përkatëse;
 - data e fillimit dhe mbarimit të periudhës së vlefshmërisë;
4. Liçenca hiqet nga Autoriteti Kompetent që e ka lëshuar atë, kur:
 - nuk plotëson më kushtin e reputacionit të mirë sipas pikës 1 të nenit 8 të Udhëzimit nr. 15, datë 24.07.2007.
 - ka paraqitur informacion jo të sakte dhe/ose të falsifikuar në lidhje me të dhënat e kërkuara për marrjen e liçencës.

VENDIM
Nr.5, datë 4.3.2008

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “

me sekretare Brunilda Bara, më datën 18.12.2007, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.56/10 Akti, që i përket:

KËRKUES: ASTRIT ZEKA, përfaqësuar nga avokat Brahim Lahi, me prokurë.

SUBJEKTI I INTERESUAR: PROKURORIA E PËRGJITHSHME, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.538, datë 27.6.2007 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi pretendon se gjatë gjykimit të çështjes penale në ngarkim të tij nuk janë respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor në këto drejtime kryesore:

- Çështja është shqyrtuar në Gjykatën e Lartë pa i njoftuar më parë rekursin atij, por dhe avokatit të caktuar prej tij.

- Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka zhvilluar gjykimin e çështjes pa praninë e tij apo të mbrojtësit dhe madje, pa caktuar as edhe një mbrojtës kryesisht.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes z.Sokol Sadushi dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, kërkuesi është dënuar me 11 vjet burgim për veprën penale të vrasjes të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal. Gjykata e Apelit Korçë ka ndryshuar cilësimin juridik të veprës, nga vrasje e thjeshtë (neni 76 i Kodit Penal) në vrasje në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme (neni 83 i Kodit Penal) dhe e ka dënuar me 6 vjet burgim. Për pjesën e mbetur të dënimit kërkuesi ka përfituar nga amnistia dhe, për rrjedhojë, në kohën që zhvillohej gjykimi në Gjykatën e Lartë, ka qenë në gjendje të lirë. Mbi bazën e rekursit të prokurorit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka prishur vendimin e Gjykatës së Apelit Korçë dhe ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Kërkuesi, në bazë të nenin 131 shkronja “f” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për kontrollin e kushtetueshmërisë së vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në drejtim të respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Në lidhje me pretendimin e kërkuesit për mosnjoftimin e rekursit, nga dosja gjyqësore rezulton se nga ana e Gjykatës së Apelit Korçë është dërguar ky njoftim, i cili nuk është nënshkruar nga kërkuesi, avokati apo persona të tjerë të njohur nga ligji procedural penal, por nga xhaxhai i tij. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në datën 18.4.2007, pasi ka verifikuar se nga aktet e dosjes nuk rezulton të jetë njoftuar i pandehuri apo avokati i tij, e ka shtyrë seancën gjyqësore për një datë tjetër.

Gjykata e Apelit Korçë, mbështetur në nenin 140 të Kodit të Procedurës Penale, në pamundësi për të bërë njoftimin për të pandehurin, pasi nuk i dihej vendbanimi, ka proceduar me komunikimin me shpallje.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka riçelur seancën gjyqësore më datën 27.6.2007, ku mungonin si i pandehuri, ashtu edhe mbrojtësi i tij. Në këto rrethana, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi mori mendimin e prokurorit të çështjes, duke arsyetuar se “komunikimi është bërë sipas kërkesave ligjore”, vazhdoi seancën gjyqësore.

Gjykata Kushtetuese konstaton se pas rekursit të paraqitur nga prokurori, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin e dhënë e ka ndryshuar *in peus* (në përkeqësim) masën e dënimit të kërkuarit, ndërkohë që ky i fundit nuk ka mundur të sigurojë mbrojtjen e tij. Në praktikën e Gjykatës Kushtetuese, në varësi të specifikës së çdo rasti konkret, mënyra e zhvillimit të gjykimit është konsideruar pjesë përbërëse e juridiksionit kushtetues, në kuptim të neneve 42 dhe 131, shkronja “f” të Kushtetutës, si dhe të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Duke iu referuar jurisprudencës gjyqësore, në mënyrë të veçantë asaj të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, përgjithësisht është pranuar që seancat gjyqësore të mos zhvillohen pa praninë e një avokati. Për shkak të zhvillimit të debatit gjyqësor për çështje të ligjit, pjesëmarrja e të pandehurit në gjykimin e çështjes në gjykatat më të larta nuk është paraqitur e domosdoshme, me përjashtim të rasteve kur cilësitë personale të të pandehurit kanë pasur rëndësi vendimtare për dhënien e drejtësisë. Mbi këtë bazë është konsideruar si i mjaftueshëm njoftimi i avokatit mbi ankimin e ushtruar në shkallët më të larta të gjykimit. Në rast se as avokati dhe as i pandehuri nuk paraqiteshin në seancë gjyqësore, është konsideruar e palejueshme vazhdimi i mëtejshëm i saj.¹

Jurisprudenca kushtetuese shqiptare, në respektim edhe të qëndrimeve të mbajtura nga Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut, ka konkluduar se nisur nga natyra e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë dhe fokusimi i saj në probleme të ligjit “pa ndihmën e një avokati, procesi nuk mund të kontribuojë në mënyrë të dobishme në shqyrtimin e çështjeve juridike që qëndrojnë në thelb të mosmarrëveshjeve”.²

Gjykimi në Gjykatën e Lartë, në dallim nga procedurat strikte të gjykimit që zhvillohen në gjykatat e zakonshme, ka si veçori paraqitjen vetëm të argumenteve ligjore. Kompleksiteti i procedurave të gjykimit në Gjykatën e Lartë konfirmohet edhe nga dispozitat ligjore që sanksionojnë se palët duhet të përfaqësohen në këtë gjykim nga avokati. Prandaj, shqyrtimi nga Gjykata e Lartë kryesisht i çështjeve të ligjit, jo vetëm që e justifikon plotësisht përfaqësimin me avokat në seancat dëgjimore, por për më tepër, bëhet i domosdoshëm për garantimin në favor të të pandehurit të një mbrojtjeje efektive dhe profesionale.

Nisur nga specifika e rastit në shqyrtim, kur çështja gjykohej mbi bazën e rekursit të paraqitur nga prokurori, i cili kishte kërkuar rëndimin e pozitës së të pandehurit, dhe faktit që as i pandehuri dhe as avokati nuk ishin të pranishëm në gjykim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk duhej të zhvillonte gjykimin pa i dhënë mundësi palës së akuzuar për të realizuar mbrojtjen ligjore. Në aspektin e garantimit të procesit të rregullt ligjor, për Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë dilte e domosdoshme marrja e masave për të lejuar zhvillimin e seancës në mungesë të përfaqësuesit të interesave të të pandehurit, si e vetmja mënyrë që i pandehuri, përmes figurës përfaqësuese të avokatit, të realizonte të drejtën për t’u mbrojtur.

Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese çmon se gjykimi i zhvilluar në Gjykatën e Lartë ka qenë i parregullt nga pikëpamja kushtetuese, për shkak se kërkuarit i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe në nenet 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

¹ Vendimin nr.23, datë 13.10.2005 i Gjykatës Kushtetuese të RSH.

² Vendimin nr.25, datë 30.7.2003 i Gjykatës Kushtetuese të RSH.

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr.538, datë 27.6.2007 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Kryetar: Vladimir Kristo.

Anëtarë: Fehmi Abdiu, Gjergj Sauli, Xhezair Zaganjori, Kujtim Puto, Kristofor Peçi, Sokol Sadushi, Sokol Berberi, Petrit Plloçi.

VENDIM Nr.6, datë 5.3.2008

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese,
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Gjergj Sauli	Anëtar i “ “

me sekretare Brunilda Bara, në datën 19.2.2008, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.3 Akti, që i përket:

KËRKUESI: PROKURORI I PËRGJITHSHËM I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, i përfaqësuar me autorizim nga z.Skënder Breca.

OBJEKTI: Interpretimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr.9, datë 11.5.2006.

BAZA LIGJORE: Neni 80 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Kërkuesi parashtroi se:

- dispozitivi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 11.5.2006 është i paqartë, sepse nuk përputhet plotësisht me pjesën arsyetuese të tij;

- në arsyetimin e vendimit janë pranuar shkelje të standardeve të gjykimit vetëm për kërkuesin Arben Prifti, ndërsa në dispozitiv krijohet përshtypja se Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar tërësisht vendimin nr.129, datë 2.3.2005 të Gjykatës së Lartë si për kërkuesin Arben Prifti, ashtu edhe për të gjykuarit e tjerë Bujar Himçi, Edmond Aliaj e Veli Myftari.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes z.Gjergji Sauli, përfaqësuesin e kërkuesit dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr.9, datë 11.5.2006, ka shfuqizuar si të papajtueshëm me

Kushtetutën vendimin nr.129, datë 2.3.2005 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, duke e dërguar çështjen për shqyrtim në këtë Kolegj.

Prokurori i Përgjithshëm, me kërkesën nr.191/1, datë 25.1.2008 drejtuar kësaj Gjykate, ka kërkuar interpretimin e vendimit nr.9, datë 11.5.2006 të Gjykatës Kushtetuese për shkak të paqartësisë së dispozitivit të vendimit në raport me pjesën arsyetuese të tij.

Duke iu referuar materialeve të çështjes dhe vendimit të saj nr.9, datë 11.5.2006, Gjykata Kushtetuese konstatoi se në pjesën arsyetuese të këtij vendimi është pranuar se në kuadrin e gjykimit të çështjes për një proces të rregullt ligjor, e drejta e mbrojtjes në këtë proces i është mohuar të gjykuarit Arben Prifti, duke përjashtuar të gjykuarit e tjerë. Ky fakt, që përbën thelbin e gjykimit të çështjes, trajtohet kuptueshëm në pjesën arsyetuese të vendimit. I paqartë paraqitet dispozitivi i vendimit, sepse nga formulimi i tij krijohet dyshimi që të jetë shfuqizuar tërësisht vendimi nr.129, datë 2.3.2005 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me efekte edhe për të gjykuarit Bujar Himçi etj.

Sipas nenit 80 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, kjo gjykatë ka në kompetencë të interpretojë vendimin e saj në rast dyshimi ose mosmarrëveshjeje për kuptimin e tij, por pa ndryshuar përmbajtjen.

Në ushtrim të kësaj kompetence, Gjykata Kushtetuese çmon se, në rastin konkret, dispozitivi i vendimit të saj nr.9, datë 11.5.2006 duhet interpretuar në pajtim dhe harmoni me pjesën arsyetuese të këtij vendimi, në të cilin janë pranuar shkelje të standardeve të gjykimit për një proces të rregullt ligjor vetëm për kërkuesin Arben Prifti. Për sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin se dispozitivi i vendimit nr.9, datë 11.5.2006, që shfuqizon si të papajtueshëm me Kushtetutën vendimin nr.129, datë 2.3.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ka efekt vetëm për kërkuesin Arben Prifti.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 80 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 11.5.2006, që shfuqizon si të papajtueshëm me Kushtetutën vendimin nr.129, datë 2.3.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, interpretohet se ka efekt vetëm për kërkuesin Arben Prifti.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Kryetar: Vladimir Kristo.

Anëtarë: Fehmi Abdiu, Gjergj Sauli, Xhezair Zaganjori, Kujtim Puto, Kristofor Peçi, Sokol Sadushi, Sokol Berberi, Petrit Plloçi.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
 Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
 Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- | | |
|--|-----------|
| 1. KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË | 600 lekë |
| 2. REGJISTRAT E NOTERISË | 1000 lekë |

BOTIME TË REJA (Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL	210 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE	332 lekë
KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar)	542 lekë
KODI CIVIL	408 lekë
KODI I PROCEDURËS CIVILE	224 lekë
KODI I PUNËS	138 lekë
KODI I FAMILJES	244 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	88 lekë
• Vendime të Gjykatës Kushtetuese	700 lekë
• Vendime të Gjykatës së Lartë	1000 lekë
• Përmbledhje legjislacioni për nëpunësin civil	200 lekë
• Përmbledhje legjislacioni në fushën e tatimeve dhe taksave	273 lekë
• Përmbledhje e legjislacionit për pasuritë e paluajtshme (Vol. I -192 lekë; Vol. II – 168 lekë, Vol. III – 185 lekë)	

Hyri në shtyp më 7.3.2008
 Doli nga shtypi më 7.3.2008

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Nënë Tereza”
 Tiranë, 2008

Çmimi 28 lekë